
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.140/22	Data: 14.07.2022	

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L të Punës dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Istogut nxjerr :

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Institucioni: Komuna e Istogut
Drejtoria: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i vendit të punës : Drejtor i Qendrës Kulturore
Numri i ekzekutuesve: 1 (një)
Lloji i pozitës: Jo i karrierës
Orari I plotë: 40 orë në javë
Kategoria Funksionale: Niveli Drejtues
Grada: Niveli i koeficient (koeficienti 9)
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar (4 vite)
Qëllimi i vendit të punës: Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e qendrës kulturore.

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Udhëheq me Qendrën për Kulturë;
2. Merr pjesë dhe ndihmon të gjitha aktivitetet dhe manifestimet që zhvillohen në kuadër të komunës;
3. Përcjell punët profesionale kulturore në nivel komunal e më gjerë;
4. Angazhohet dhe përkrah të gjitha shoqëritë kulturore dhe shoqatat e të rinjve si në mënyrë profesionale, ashtu edhe në aspektin financiar brenda buxhetit të lejuar;
5. Menaxhon dhe mbikëqyrë projekte të ndryshme kulturore;
6. Bashkëpunon me udhëheqësit e të gjitha shoqërive kulturo-artistike në nivel komunal e më gjerë;
7. Pranon të gjitha aktet dhe shkresat nga DKRS-ja, si dhe i regjistron dhe i shpërndan sipas dedikimit;
8. Për punën e vet i përgjigjet drejtorit të drejtorisë.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Aftësi të plotë për përmbushjen e detyrave të vendit të punës, me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore;
- Përgatitje universitare: Fakulteti Juridik, Ekonomik, Administratë Publike (240 kredi/ECTS);
- Aftësi të mira analitike dhe komunikuese;
- Të ketë katër (4) vite përvojë pune menaxheriale-drejtuese;
- Njohuri të punës me kompjuter;
- Aftësi të tjera që shërbejnë për kryerjen e detyrave të punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar;
- Diploma universitare;
- Dëshmi mbi përvojën e punë;
- Kopja e letërnjoftimit
- Dëshmin se nuk jeni nën hetime, nga gjykata.

Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin intervistimit.

Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata , të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit :

Konkursi mbetet i hapur nga 15.08.2022 deri me 29.08.2022.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Kosovës si dhe nëpër kolegjet private Brenda Republikës së Kosovës, e që konkurojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga MASHT-I në pajtim me udhëzimin administrative, Nr.12/2018 të dates 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushtë të konkursit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të pranohen , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Menaxheri i Peronelit
Fatmir Bytyci

